

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Menaxherial

P2

Zgjidhjet

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE
All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test

Data: 05.12.2020

Problemi 1

Informatat e mëposhtme janë dhënë për ABC, bazuar në informatat e vitit financiar 2020:

- (i) Buxhetimi i orëve të punës direkte (PD) 80,000 orë
(ii) Buxhetimi i shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit:
- | | |
|-----------|----------|
| Variabile | €400,000 |
| Fikse | €320,000 |

- (iii) Orët aktuale të punës direkte 65,000 orë
(iv) Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit aktuale:
- | | |
|-----------|----------|
| Variabile | €285,000 |
| Fikse | €315,000 |

Kërkohet:

- (a)
1. Kalkuloni shkallën e paracaktuar për shpenzimet e përgjithshme të prodhimit (Sh.P.SHPP) bazuar në orët e punës direkte. **(4 pikë)**
 2. Kalkuloni shpenzimet e përgjithshme të aplikuara për periudhën. **(2 pikë)**
 3. Kalkuloni shumën e nënaplikimit apo mbiaplikimit për shpenzimet e përgjithshme të prodhimit për periudhën dhe sqaroni nese janë të nën apo mbi vlersuara. **(4 pikë)**

(b)

Doral Company prodhon dhe shet stilografë. Aktualisht, 5,000,000 njësi janë shitur me €0.50 për njësi. Kostot fikse janë €900,000 për vit. Kostot variabile janë €0.30 për njësi.

1. **Sa janë tani:** **(4 pikë)**
 - a. Të ardhurat operative për vitin?
 - b. Pika e rentabilitetit në të hyra (€)?
2. **Kalkuloni fitimin e ri operativ për secilin nga ndryshimet e mëposhtme (4 pikë)**
 - a. Për €0.04 për njësi rriten kostot variabile
 - b. Për 10% rriten kostot fikse dhe 10% rritet numri i njësive të shitura.
 - c. Për 20% zvogëlohen kostot fikse dhe për 20% zvogëlohet çmimi i shitjes,dhe 10% zvogëlohen kostot variabile për njësi,dhe 40% rritet numri i njësive të shitura.
3. **Kalkuloni pikën e re të rentabilitetit në njësi për secilin nga rastet e mëposhtme: (2 pikë)**
 - a. Për 10% rritje e shpenzimeve fikse
 - b. Për 10% rritje e çmimit të shitjes dhe €20,000 rritje të kostove fikse

(Totali = 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

(a)

1. Totali i shpenzimeve të përgjithshme të buxhetuara = Shpenzimet e përgjithshme variabile të buxhetuara + Shpenzimet e përgjithshme fikse të buxhetuara
Totali i shpenzimeve të përgjithshme të buxhetuara = €400,000 + €320,000
Totali i shpenzimeve të përgjithshme të buxhetuara = €720,000

Shkalla e paracaktuar e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit = Totali i shpenzimeve të përgjithshme të buxhetuara / orët e punës direkte të buxhetuara

$$\text{Shpshpp} = €720,000 / 80,000 \text{ orë}$$

$$\text{Shpshpp} = 9.00 \text{ € / orë}$$

2. Shpenzimet e përgjithshme të aplikuara = Shkalla e paracaktuar e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit x orët aktuale të punës direkte
Shpenzimet e përgjithshme të aplikuara = 9€ / orë x 65,000 orë
Shpenzimet e përgjithshme të aplikuara = €585,000

3. Shpenzimet e përgjithshme aktuale të prodhimit = Shpenzimet e përgjithshme aktuale të prodhimit variabile + Shpenzimet e përgjithshme aktuale të prodhimit fikse = €285,000 + €315,000
Shpenzimet e përgjithshme aktuale të prodhimit = € 600,000

Shpenzimet e përgjithshme aktuale të prodhimit - Shpenzimet e përgjithshme të aplikuara = nën ose mbi aplikimi i shpenzimeve të përgjithshme

$$€600,000 - €585,000 = €15,000$$

Shpenzimet e përgjithshme të aplikuara të prodhimit janë më të ulëta se ato aktuale andaj në këtë rast është nën aplikim i SHPP

(b)

- 1a. Të ardhurat operative = [njësitë e shitura (Çmimi i shitjes - Kosto variabile)] - Kosto fikse
Të ardhurat operative = [5,000,000 (€0.50 - €0.30)] - €900,000 = €100,000

- 1b. Pika e rentabilitetit(njësi) = Kosto fikse ÷ Marzhina e kontributit
Pika e rentabilitetit(njësi) = €900,000 ÷ [(€0.50 - €0.30)] = 4,500,000 njësi

Pika e rentabilitetit(në të hyra) = pika e rentabilitetit(njësi) × Çmimi i shitjes
Pika e rentabilitetit(në të hyra) = 4,500,000 njësi × €0.50 për njësi = €2,250,000

2a. Fitimi operativ = 5,000,000 (€0.50 - €0.34) - €900,000 = € (100,000)

2b. Fitimi operativ = [5,000,000 (1.10) (€0.50 - €0.30)] - [€900,000 (1.10)] = € 110,000

2c. Fitimi operativ = [5,000,000 (1.40) (€0.40 - €0.27)] - [€900,000 (0.80)] = € 190,000

3a. Pika e rentabilitetit(njësi) = €900,000(1.10) ÷ (€0.50 - €0.30) = 4,950,000 njësi

3b. Pika e rentabilitetit(njësi) = (€900,000 + €20,000) ÷ (€0.55 - €0.30) = 3,680,000 njësi

Problemi 2

1. ABC LTD përdor sistemin e njësive ekuivalente. Informacionet e mëposhtme janë në dispozicion për vitin 2020:

Numri i njësive i stoqeve të punës në proces në fillim	4,000	(30% të kompletuara)
Numri i njësive të filluara gjatë periudhës	35,000	
Numri i njësive i stoqeve të punës në proces në fund	3,000	(80% të kompletuara)

Referuar informatave të mësipërme të ABC LTD, sa njësi ekuivalente janë kompletuar në periudhën e tanishme? (7 pikë)

2. ABC Inc. shkaktoj shpenzimet aktuale të përgjithshme të prodhimit prej €62,000 në vitin 2020 për prodhimin e 10,000 njësive. Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit janë aplikuar në shkallën prej €2.00 për orë të punës direkte dhe 3 orë të punës direkte janë buxhetuar për secilin njësi. Kompania përdori 29,000 orë të punës direkte për procesin e prodhimit.

Duke iu referuar informatave të mësipërme të ABC Inc, sa është varianca e efikasitetit të shpenzimeve të përgjithshme? (8 pikë)

3. ABC dokumentoi numrin e kopjeve të bëra për klientët e tij si dhe kostot totale të përgjithshme të prodhimit për pesë muajt e kaluar të votit 2019 si më poshtë:

	<u>Numri i kopjeve</u>	<u>Kostot totale të përgjithshme të prodhimit</u>
Tetor	230,000	€7,400
Nëntor	240,000	7,500
Dhjetor	280,000	8,000
Janar	265,000	7,700
Shkurt	248,000	7,550

Duke iu referuar informacioneve të mësipërme të Lonni, duke përdorur metodën e Lart/Ulët, shkruani ekuacionin për shpenzimet e përgjithshme të prodhimit? (5 pikë)

(Totali = 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

1. 37,200 njësi ekuivalente

Kalkulimi: $[(4,000 \times 0.7) + (35,000 - 3,000) + (3,000 \times 0.8)]$

2. €2,000 Favorshme

Kalkulimi: $[(10,000 \times 3) - 29,000] \times 2$

3. $Y = €4,640 + €0.012x$

Kalkulimi: $[(8,000 - 7,400) / (280,000 - 230,000)] = 0.012$ (pjesa variabile);

$[8,000 - (0.012 \times 280,000)] = 4,640$ (pjesa fikse)

Problemi 3

ABC Kompania ka një linjë të vetme të prodhimit, ku prodhon tri produkte - X , Y dhe Z. Kapaciteti vjetor i orëve të makinerisë në dispozicion është i kufizuar në 18,650 orë. Pasqyra e buxhetuar e fitimit/humbjeve bazuar në kërkesat e shitjeve për secilin produkt për vitin e ardhshëm është paraqitur më poshtë.

	<u>X</u>	<u>Y</u>	<u>Z</u>
Të hyrat nga shitjet	1,130,000	624,950	1,000,000
Kostot e materialeve dhe punës (variabile)	565,000	438,000	500,000
ShPP variabile	180,000	62,000	250,000
Shpenzimet fikse	<u>315,000</u>	<u>130,000</u>	<u>200,000</u>
Fitimi / (humbja)	70,000	(5,050)	50,000
Shitjet vjetore të kërkesës(njësi)	4,000	1,500	2,500
Orët e makinerisë për njësi	2.75	3.50	2.50

Kërkohet:

- Llogaritni kufizimin e orëve të makinerisë në dispozicion për vitin e ardhshëm. **5 pikë**
- Llogaritni kontributit për produkt, njësi të produktit dhe për orë të makinerisë të përdorur për secilin produkt. Radhitni secilin produkt bazuar në kontributin për njësi të faktorit kufizues. **8 pikë**
- Llogarit numrin e njësive të secilit produkt që duhet të prodhohet vitin e ardhshëm në mënyrë që të maksimizohet fitimi. **4 pikë**
- Çfarë është një kufizim/pengesë? **3 pikë**
 - Një kufizim i brendshëm?
 - Një kufizim i jashtëm?

(Totali = 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

a. Faktori kufizues

	<u>Njësi</u>	<u>Orë për njësi</u>	<u>Σ i orëve</u>
Produkti X	4,000	2.75	11,000
Produkti Y	1,500	3.50	5,250
Produkti Z	2,500	2.50	6,250
Totali i orëve të duhura të makinerisë			22,500
Orët e makinerisë në dispozicion			18,650
Kufizimi në disponueshmërinë e orëve të makinerisë			3,850

b. Kontributi për produkt, njësi të produktit dhe për orë të makinerisë.

	<u>X</u>	<u>Y</u>	<u>Z</u>
Të hyrat nga shitja	1,130,000	624,950	1,000,000
Kostot e materialeve dhe punës (variable)	565,000	438,000	500,000
ShPP variable	180,000	62,000	250,000
Marzha e kontributit	385,000	124,950	250,000
Kontributi për njësi	96.25	83.30	100.00
Kontributi për orë të makinerisë	35.00	23.80	40.00
Rangimi	<u>2</u>	<u>3</u>	<u>1</u>

c. Numri i njësive që duhet të prodhohet.

<u>Rangimi</u>	<u>Produkti</u>	<u>Kërkesa (njësi)</u>	<u>Orë për njësi</u>	<u>Orët e nevojshme</u>	<u>Orët në dispozicion</u>	<u>Njësi për t'u prodhuar</u>
1	Z	2,500	2.50	6,250	6,250	2,500
2	X	4,000	2.75	11,000	11,000	4,000
3	Y	1,500	3.50	5,250	1,400	400
				22,500	18,650	

d. Kufizimet (pengesat) paraqesin kufizimet e burimeve apo kufizimin e kërkesës për një produkt.

- Kufizimet e brendshme janë faktorë pengues që gjenden brenda kompanisë (të tillë si vlefshmëria e kohës/orëve të punës apo makinerisë).
- Kufizimet e jashtme janë faktorë pengues të vendosur mbi kompaninë nga burime të jashtme (të tillë si kërkesa e tregut)

Problemi 4

Kompania ABC, nëpërmjet zinxhirit të saj të dyqaneve me pakicë, shet 380,000 njësi të Produktit AA çdo vit. Kompania ABC shkakton kosto prej €57 për porosi të bërë Prodhuesit të Produkt AA, dhe një kosto vjetore të mbajtjes së stokeve prej €12 për njësi. Udhëheqësi i furnizimit në Kompaninë ABC dëshiron të kuptoi se si kostot e porositjes dhe mbajtjes së stokeve të ndryshojnë për sasi të porositura.

Kërkesa vjetore (njësi)	380,000	380,000	380,000	380,000	380,000
Kosto për porosi të blerjes	€ 57	€ 57	€ 57	€ 57	€ 57
Kosto vjetore e mbajtjes për njësi	€ 12	€ 12	€ 12	€ 12	€ 12
Sasia (numri i njësive) për porosi	760	1,000	1,900	3,800	4,750
Numri vjetor i porosive					
Kosto vjetore përkatëse të porositjes					
Kosto vjetore përkatëse të mbajtjes					
Kosto vjetore përkatëse të porositjes dhe të mbajtjes së stokeve					

Kërkohet:

1. Çfarë janë kostot e porositjes? Çfarë janë kostot e përgatitjes? Çfarë janë kostot e mbajtjes? Jepni shembuj të secilës lloj kostoje **3 pikë**
2. Plotësoni tabelën. Komentoni rezultatet tuaja. Çfarë është SPE (EOQ)? Konfirmoni llogaritjen përmes formulës $SPE = \sqrt{\frac{2DP}{C}}$ **9 pikë**
3. Prodhuesi i Produktit AA është duke përgatitur një sistem të porositjeve përmes rrjetit të kompjuterizuar për klientët e tij. Udhëheqësi i furnizimit në Kompaninë ABC vlerëson se kosto e porositjes do të zvogëlohen në €30 për porosi. Llogaritni SPE (EOQ) e re dhe shpenzimet e reja vjetore përkatëse të porositjes dhe mbajtjes së stokeve. **5 pikë**
4. Udhëheqësi i furnizimit në Kompaninë ABC vlerëson që do të shkaktohet një kosto prej €2,150 për të trajnuar zyrtarët e furnizimit për të përdorur sistemin e ri të porositjes përmes rrjetit të kompjuterizuar. Kur dhe si do të mbulojë shpenzimet e trajnimit Kompania ABC? **3 pikë**

Problemi 4

1. *Kostot e porosive* - janë kostot e vendosjes dhe marrjes së një porositë. *Shembuj* përfshijnë koston e përpunimit të një porositë (kostot e zyrës dhe dokumenteve), sigurimi për dërgesën dhe kostot e shkarkimit.

Kostot e përgatitjes - janë kostot e përgatitjes së pajisjes dhe mjediseve që ato të përdoren për të prodhuar një produkt ose përbërës të veçantë. *Shembuj* janë pagat e punonjësve të prodhimit pa punë, kostoja e mjediseve të prodhimit pa punë (e ardhur e humbur) dhe kostot e testeve (puna, materialet dhe kosto indirekte).

Kostot e mbajtjes - janë kostot e mbajtjes së stokeve. *Shembuj* përfshijnë sigurimin, tatimet mbi stoqet, vjetrimin, koston oportune të fondeve të bllokuara në stoqe, kostot e zhvendosjes dhe hapësirën e magazinimit.

2.

Kërkesa vjetore (njësi)	D =	380,000	380,000	380,000	380,000	380,000
Kosto për porosi të blerjes	P =	€57	€57	€57	€57	€57
Kosto vjetore e mbajtjes për njësi	C =	€12	€12	€12	€12	€12
Sasia (numri i njësive) për porosi	Q =	760	1,000	1,900	3,800	4,750
Numri vjetor i porosive	D/Q =	500	380.00	200	100	80
Kosto vjetore përkatëse të porosites(D/Q*P)		28,500	21,660	11,400	5,700	4,560
Kosto vjetore përkatëse të mbajtjes(Q*C)		4,560	6,000	11,400	22,800	28,500
Kosto vjetore përkatëse të porosites dhe të mbajtjes së stokeve[(D/Q)*P] + [(Q)*C]		33,060	27,660	22,800	28,500	33,060

Sasia e porosisë ekonomike është 1,900 njësi. Sasia e porosisë ekonomike (SPE –EOQ) është sasia e stokeve që duhet të porositet çdo herë, në mënyrë të minimizimit të shumës së kostove të porosites dhe mbajtjes. Derisa SPE minimizon shumën e këtyre kostove, gjithashtu SPE barazon kostot e porosites me kostot e mbajtjes.

Kjo mund të vërtetohet edhe duke përdorur formulën $\sqrt{\frac{2DP}{C}}$ ku,

D = 380,000 njësi

P = €57 për porosi

C = €12 për njësi

$$SPE = \sqrt{\frac{2 \times 380,000 \times €57}{€12}} = \underline{\underline{1,900 \text{ njësi}}}$$

Kostoja përkatëse totale (e porosites dhe e mbajtjes) = €11,400 + €11,400 = €22,800

3. Zvogëlimi i kostove të porosites në €30 për porosi:

$$SPE = \sqrt{\frac{2 \times 380,000 \times €30}{€12}} = \underline{\underline{1,378.40 \text{ njësi}}}$$

SPE zvogëlohet prej 1,900 njësive në 1,378.40 njësi kur kostoja e porositjes zvogëlohet prej €57 në €30.

$$\text{Kostoja e re përkatëse e porositjes} = \left(\frac{D}{Q} \times P \right) = \left(\frac{380,000}{1,378.40} \times €57 \right) = \underline{\underline{€8,270.43}}$$

$$\text{Kostoja e re përkatëse e mbajtjes} = \left(\frac{Q}{2} \times C \right) = \left(\frac{1,378.40}{2} \times €12 \right) = \underline{\underline{€8,270.43}}$$

$$\text{Kostoja e re përkatëse totale (e porositjes dhe e mbajtjes)} = €8,270.43 + €8,270.43 = \underline{\underline{€16,540.86}}$$

4. Si është e paraqitur më poshtë, sistemi i ri i porositjes përmes rrjetit të kompjuterizuar për Produktin AA, duke ulur SPE nga 1,900 njësi në 1,378.40 njësi, do të ulë kostot e porositjes dhe mbajtjes për €6,259.14 (€22,800.00 - €16,540.86). Kompania ABC, gjithsej do të shpenzoi €2,150 për të trajnuar zyrtarët e saj për të përdorur sistemin e ri të porositjes përmes rrjetit të kompjuterizuar. Duke kursyer nga kostoja e re përkatëse totale e porositjes dhe e mbajtjes €6,259.14 shpenzimet e trajnimit mund të mbulohen në tërësi gjatë vitit. Gjithashtu, Kompania ABC në total do të përfitoi vlerën prej €4,109.14 nga ky sistem i ri i porositjes po atë vit.

Kostoja përkatëse totale (SPE = 1,900.00)	€22,800.00
Kostoja e re përkatëse totale (SPE = 1,378.40)	<u>€16,540.86</u>
Përfitimi total vjetor nga sistemi i ri (€22,800.00 - €16,540.86)	€6,259.14
Kostot e trajnimit	<u>2,150.00</u>
Përfitimi neto i vitit	<u>€4,109.14</u>

Problemi 5

a. ABC. ka mbiaplikuar shpenzimet e përgjithëshme të prodhimit (Sh.p.p.) për €14,300, Sh.p.p. të buxhetuara ishin €200,000, dhe numri i buxhetuar i njësive ishte 20,000.
Sh.p.p. aktuale ishin €203,000.

Sa ishte numri aktual i njësive prodhuara? (5 pikë)

b. ABC co. ka dy departamente prodhimi (P1 dhe P2), dhe dy departamente shërbimi (S1 dhe S2). Shpenzimet e përgjithëshme të prodhimit janë ndarë si më poshtë nëpër departamente :

Sh.p.p :

P1 €3,000, P2 €5,000

S1 €1,000, S2 €900

S1 shpenzon 20% të kohës së tij të punës për P1, dhe kohën e mbetur të punës për P2.

S2 shpenzon në mënyrë të barabart kohën e punës për P1,P2 dhe S1.

Sa do të jenë kostot totale të përgjithëshme (SHPP) kur kostot të rishpërndahen në mënyrë të përsëritur (metoda reciproke)? (5 pikë)

c. LIEN normalisht punon 35 – orë në javë. Megjithatë në javën e 14, për shkak të një prishje në makineri i është dashur të punoj 12 orë plotësuese (jashtë orarit). Makineria ishte jashtë përdorimit për 10 orë, dhe është regjistruar si kohë e humbur. Pol paguhet me €10 ora, dhe 150% për orët plotësuese (jashtë orarit).

1. Sa nga fitimet e Pol në javën e 14 do të regjistrohen si punë direkte? (paraqiteni kalkulimet). (5 pikë)

2. Sa nga fitimet e Pol në javën e 14 do të regjistrohen si punë indirekte? (paraqiteni kalkulimet). (5 pikë)

(Totali = 20 pikë)

Zgjidhja - 5

a.

	€
Sh.p.p. të alokuara:	21,730 njësi x (€200,000 / 20,000 njësi) = 217,300
Sh.p.p. aktuale	(203,000)
	14,300

b.

	P1€	P2€	S1€	S2€
ShPP	3,000	5,000	1,000	900
Ri-alokimi S2	300	300	300	(900)
Re-alokimi S1	260	1,040	(1,300)	-
Gjithsejt sh.p.p.	3,560	6,340	zero	zero

SHPP P1 = 3,560€

SHPP P2 = 6,340€

c.

1.

€10 x 37 orë = €370

2.

(€5 x 12 orë) + (€10 x 10 orë) = €160